

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.A. nga Prishtina, për shkak të veprës penale të vjedhjes si bashkë kryes nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-se, duke vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, av. A.H., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc, P.nr.327/18 të datës 03.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.08.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e pjesërishtëm të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit V.A., av. A.H., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc, P.nr.327/2018 i dt. 03.06.2018, vetëm sa i përket vendimit për dënimin me burgim, ashtu që kolegji i kësaj gjykate të akuzuarit për veprën penale të vjedhjes si bashkë kryes nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 3 të KPK, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajve, i cili dënim është duke ekzekutuar. Në dënimin e shqiptuar me burgim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim duke filluar nga data 02.06.2018 e deri në përfundim të dënimit të shqiptuar me burgim.

II. Në pjesët tjera aktgjykimi ngel i pa ndryshuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, P.nr.327/2018 i dt. 03.06.2018, është shpallur fajtor i akuzuari V.A., për shkak të veprës penale të vjedhjes si bashkë kryes nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-se, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1(një) viti, të cilin dënim i akuzuari do ta vuaj menjëherë deri në përfundim të njëjtit. Paraburgimi i është caktuar në kuptim të dispozitës së nenit 367 par.3 lidhur me par.7 pika 1.1 të KPK, i cili do të llogaritet në kuptim të nenit 83 par.1 të KPK-së, prej datës 02.06.2018 gjerë në përfundim të dënimit të shqiptuar me burgim.

Gjithashtu të akuzuarit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në shumë prej 500 euro, të cilin dënim është obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë kë aktgjykimit.

Nëse i akuzuari dënimin me gjobë, në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj, atëherë i njëjti do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kuptim të nenit 47 lidhur me nenin 46 par.3 të KPK-së., duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzet) euro, që nënkupton 25 (njëzetepesë) ditë burgim.

Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sa do që të jenë bërë ato në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 50(pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjithashtu është obliguar i akuzuari që për programin për kompensimin e viktimave të paguaj taksën prej 30 (tridhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë, mbrojtësi i të akuzuarit V.A., av. A.H. për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe shpenzimet e procedurës penale, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me gjobë ose dënimi me kusht.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.677/2018, të datës 30.07.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të neni 390 të KPPK, ka caktuar seancën e kolegjit dhe i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës. Nga shkresat e lëndës rezulton se në seancë të kolegjit ka prezantuar i akuzuari V.A., mbrojtësi i të akuzuarit av. A.H., kurse i dëmtuari dhe Prokurori i Prokurorisë së Apelit nuk kanë prezantuar, përkundër asaj se janë njoftuar me rregull, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.A., av. A.H., është pjesërisht e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal si dhe shpenzimet e

procedurës penale, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe shkeljet e ligjit penal, mirëpo me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënim të ashpër, sikurse është dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë. Jemi të bindur se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në masë të duhur rrethanat lehtësuese, sikurse janë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën e kryer penale, pasi që ka kuptuar natyrën e pranimin të fajësisë, se është penduar thellësisht dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin, se u ka kërkuar falje të dëmtuarve për veprimin e kryer dhe ka shfaqur gatishmëri që dëmin të cilin u ka shkaktuar tua kthej në dyfishin e shumës së marrur, se nga kjo veprë penale ka humbur kredibilitetin, andaj në prani të këtyre rrethanave jemi të mendimit që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i butë me të holla, si dhe dënimi me burgim të jetë i kushtëzuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimit, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se i akuzuari ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se është penduar thellësisht dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin, se ka kërkuar falje nga ana e të dëmtuarve, dhe ka shprehur gatishmëri që ta kompensojë dëmin e shkaktuar, se është i martuar, baba i dy fëmijëve, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar, shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprës penale, mirëpo ka vlerësuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, e sidomos pendueshmërinë e të akuzuarit, si dhe gatishmërinë që ta kompensojë dëmin e shkaktuar, të cilat rrethana i ka vlerësuar si posaçërisht lehtësuese, ashtu që në prani të këtyre rrethanave, kolegji i kësaj gjykatë ka vendosur që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe të akuzuarit për veprën penale të vjedhjes ti shqiptoj dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8(tetë) muajve, duke qenë të bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Sa i përket dënimin me gjobë i njëjti ngel i pa ndryshuar, sepse kolegji i kësaj gjykate mendon se është i drejtë dhe i bazuar në ligj, sikurse është edhe vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.670/2018, të datës 16.08.2018

Zyrtari ligjor
Bajram Rexhahmetaj

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Gani Zabeli

Biljana Rexhiq